



Libri 9 MIQTË E MI është hartuar sipas fushave kurrikulare: zhvillimi gjuhësor, matematikor, shkencor, artistik, social dhe shëndetësor. Libri është strukturuar me 9 kapituj, që iu përgjigjen 9 muajve mësimorë, nga tetori deri në qershor. Në secilin muaj fëmija do të njihet me nga një personazh: Arusha Ada, Dinozauri Dino, Tigri Tigo, Pinguini Pigo, Majmuni Moja, Flutura Fufu, Patoku Pam, Bretkosa Besi, Lepurushi Lori. Nëpërmjet ilustrimeve tërheqëse dhe personazheve zbavitëse, fëmija njëkohësisht do të mësojë dhe do të argëtohet. Çdo mësim ka një ose dy faqe, ku fëmija heton (investigon), lexon figurën, tregon, dallon, numëron, pyet, përgjigjet, vepron, zgjedh (rrugën drejtimin), lidh të njëjtat, dallon ndryshimet. ngjyros, vizaton, shkruan. Pra. në çdo faqe fëmija nxitet për të mësuar njohuri të reja e për të punuar në mënyrë të pavarur.

Një mësim mund të punohet në disa orë mësimore, sa e sheh të arsyeshme mësuesja për të realizuar objektivat e parashikuara. Në krye të çdo faqeje janë disa kërkesa që përmbajnë thelbin e veprimit që duhet të bëjë fëmija. Këto kërkesa e orientojnë edhe prindin për punën që fëmija mund të bëjë në kushte shtëpie.